L I G J
Nr.8784, datë 7.5.2001

PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KANADASË PËR NDËRTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Kanadasë për ndërtimin e vendqëndrimit të ri të avionëve civilë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3012, datë 18.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË KANADASË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
LIDHUR ME NDËRTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILË
NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT

Qeveria Kanadeze e quajtur "KANADA" dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë e quajtur "SHQIPËRIA", duke dashur të bashkëpunojnë për vënien në jetë të projektit KANADEZ të asistencës në Shqipëri, kanë arritur mirëkuptimin (marrëveshjen) e mëposhtme:

Neni 1
Natyra e Memorandumit të Mirëkuptimit

Paragrafi 1.01
Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk përbën një traktat ndërkombëtar. Ai ka si qëllim të caktojë përgjegjësitë KANADEZE dhe SHQIPTARE në lidhje me Projektin e përshkruar në nenin 3.

Neni 2
Autoritetet përgjegjëse

Paragrafi 2.01

KANADAJA emëron Agjencinë Ndërkombëtare Kanadeze të Zhvillimit (e quajtur "CIDA") të marrë përsipër përgjegjësitë e saj sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Drejtuesi i Departamentit Kanadez të Mbrojtjes Kombëtare do të jetë Menaxher i Projektit në emër të Shqipërisë dhe Kanadasë.

Paragrafi 2.02

SHQIPËRIA emëron Ministrinë e Transportit (e quajtur "MOT") , përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil të marrë përsipër në vazhdimësi ndërlidhjen dhe përgjegjësitë përkatëse në emër të Shqipërisë, gjatë zbatimit të projektit të përshkruar në nenin 3.

Neni 3
Projekti

Paragrafi 3.01

Kanadaja dhe Shqipëria do të marrin pjesë në implementimin e projektit (i quajtur "Projekt"). Qëllimi i këtij Projekti është të ndërtojë një vendqëndrim të ri për avionët civilë në Aeroportin e Rinasit, sipas përshkrimit të bërë në Projektplanin e Menaxhimit në Aneksin "A".

Paragrafi 3.02

Projekti është përshkruar në anekset "A", "B", dhe "C" të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 4
Plani i Menaxhimit

Paragrafi 4.01

Për qëllimin e implementimit të Projektit, KANADAJA dhe SHQIPËRIA, do të zhvillojnë një Plan Menaxhimi i cili do të përbëjë një dokument operimi midis CIDA/DND dhe DGA/MOT. Plani i Menaxhimit do të kompletohet dhe nënshkruhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, dhe kur të nënshkruhet në kohën e duhur në emër të KANADASË dhe SHQIPËRISË, do të bashkëngjitet si Aneksi "A" dhe do të përmbajë midis të tjerave:

një përshkrim të detajuar të projektit;

një skicë të metodave dhe ideve që do të përdoren për implementimit e Projektit;

një kalendar për implementimin e aktiviteteve të projektit, përfshirë dhe buletinin historik;

raportimin e kërkesave të projektit;

natyrën, kohëzgjatjen dhe përgjegjësitë për vlerësimet e Projektit dhe mjetet për arritjen e tyre;

burimet e kërkuara për projektin; dhe

një deklaratë të detyrimeve shtesë, detyrat dhe përgjegjësitë e KANADASË dhe SHQIPËRISË, së bashku me kontributet e tyre.

Plani i menaxhimit mund të përmirësohet me një mirëkuptim të përbashkët prej DND dhe Drejtorit të Aeroportit të Rinasit, pa ndjekur procedurat formale të përmirësimit.

Neni 5
Kontributi i Kanadasë

Paragrafi 5.01

Kontributi i KANADASË, do konsistojë në sigurimin e asistencës teknike për implementimin e projektit. Vlera totale e kontributit kanadez nuk do t'i kaloje 2.1 milion USD kanadezë. Kontributi i Kanadasë përshkruhet në Anekset "A" dhe "B" të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Paragrafi 5.02

Të ardhurat e kontributit kanadez nuk do të përdoren nga projekti për të paguar taksë tatimet apo taksat doganore, VAT ose ndonjë taksë apo detyrim tjetër, ngarkuar direkt ose indirekt nga Shqipëria në mallrat, materialet, pajisjet, kamionët ose shërbimet e paguara ose të pranuara për të përballuar kërkesat e projektit ose në lidhje me implementimin e projektit.

Neni 6
Kontributi i Shqipërisë

Paragrafi 6.01

Kontributi i Shqipërisë është përshkruar ne Anekset "A" dhe "C" dhe do të konsistojë në sigurimin e kushteve të nevojshme për implementimin e projektit dhe kontribute të tjera të nevojshme për të përballuar kërkesat e projektit.

Paragrafi 6.02

Shqipëria do të sigurojë në kohë lejet për të ndërmarrë projektin, duke përfshirë lejet e ndërtimit.

Neni 7
Përcaktimi i firmës Kanadeze dhe personeli

Paragrafi 7.01

Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi:

"Firmë Kanadeze" nënkupton Departamentin Nacional të Mbrojtjes Kanadeze, lidhur me projektin, i cili është formuar sipas ligjeve kanadeze.

"Personel Kanadez" nënkupton kanadez ose shtetas të tjerë ndryshe nga shqiptarë ose qytetarë me qëndrim jo të përhershëm në Shqipëri, të cilët punojnë për projektin në Shqipëri.

"Persona në varësi" nënkupton:

a) personin e regjistruar si bashkëshort (e) i një anëtari kanadez të personelit;

b) një fëmijë i një anëtari kanadez të personelit ose bashkëshorti (ja) e tij që është nën 21 vjeç dhe në varësi të anëtarit kanadez të personelit ose bashkëshorti (ja) e tij për mbështetje për arsye të paaftësisë fizike ose mendore.

Neni 8
Dëmshpërblimi

Paragrafi 8 . 01

SHQIPËRIA do dëmshpërblejë dhe do ruajë të pa cenuar KANADANË, DND, personelin kanadez të punësuar nga projekti për përgjegjësi civile , për aktet e lënies në dorë të shfaqura gjatë përmbushjes së detyrës në implementimin e projektit përveç akteve të ngritura nga neglizhenca e madhe ose sjellja e keqe me dashje e DND ose personelit Kanadez .

Paragrafi 8. 02

Anëtarët e forcave kanadeze dhe personeli i Departamentit Kanadez të Mbrojtjes Nacionale që veprojnë në implementimin e këtij MOU do jenë subjekt i parashikimeve të Nenit 8 të Marrëveshjes midis Palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, lidhur me statusin e forcave të tyre të datës 19 qershor 1951 (NATO SOFA) si e përfshirë nga marrëveshja midis shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të Shteteve të tjera që marin pjesë në Partneritetin për Paqe, duke patur parasysh statusin e forcave të tyre datë 19 qershor (PfP SOFA)

Neni 9

Taksa dhe përjashtimet e tjera

Paragrafi 9.01

Statusi i anëtarëve të forcave Kanadeze dhe të departamentit Kanadez të Mbrojtjes Nacionale, të përfshira në implementimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi në Shqipëri, do të jetë në përputhje me klauzolat e (NATO SOFA) si e përfshirë në PfP SOFA.

Paragrafi 9. 02

SHQIPËRIA do të përjashtojë tërë përsonelin Kanadez dhe familjarët e varur prej tyre në projekt prej të gjitha taksave personale lokale, VAT dhe tatimeve, duke përfshirë taksa për personin për udhëtimet jashtë vendit, si dhe taksën mbi të ardhurat, me kusht që të ardhurat e siguruara të dalin jashtë SHQIPËRISË ose nga fondet e ndihmës Kanadeze, siç parashikohet në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Përveç kësaj, SHQIPËRIA do të përjashtojë gjithë personelin Kanadez prej çdo obligimi të bërë prezent me deklaratë me shkrim në lidhje me këto përjashtime .

Paragrafi 9.03

Shqipëria do të përjashtojë DND dhe personelin Kanadez nga taksat e importit, tarifa doganore, VAT dhe llojet e tjera të taksave, detyrimeve ose taksave për pajisjet teknike profesionale për përdorim në Projekt nga Personeli Kanadez ose personave të emëruar nga KANADAJA dhe DND, me kusht që ky përjashtim nga taksat tarifat, detyrimet ose tatimet do të aplikohet ne mallrat ose pajisjet e siguruara në vend dhe jashtë Shqipërisë. Kjo përfshin për shembull, blerjen e çimentos, shkëmbinjve të thërmuar, zhavorrit etj.

Paragrafi 9. 04

SHQIPËRIA do të përjashtojë personelin Kanadez dhe familjarët e tyre që nga ardhja e tyre në Shqipëri nga taksat doganore e tjera, VAT, tatimet dhe detyrimet e tjera të ngjashme në pajisjet personale dhe mjetet, subjekt të rieksportimit ose të mbarimit të periudhës së përdorimit të pajisjeve të tilla ose të atyre pajisjeve në fjalë që janë në dispozicion të personave që gëzojnë këto këto përjashtime. Në rastet e zjarrit ose të vjedhjes, ky përjashtim mund të ribëhet në çdo moment gjatë caktimit të personelit Kanadez.

Paragrafi 9. 05

Fondet, pajisjet, produktet, materialet dhe të mirat e tjera të siguruara për implementimin e Projektit nuk do të jenë subjekt të çdo lloj takse, duke përfshirë VAT, taksat e importit, tarifat doganore, taksat e inspektimit ose detyrimet që kanë të bëjnë me magazinimin ose tatimet, taksat apo detyrimet e tjera.

Paragrafi 9. 06

Shqipëria do t'i garantojë personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre liri nga kufizimet e shkëmbimit të monedhave në lidhje me rieksportimin e rrogave të tyre, shpërblimeve ose të të ardhurave të tjera transferuar nga jashtë përmes bankave të autorizuara në SHQIPËRI.

Paragrafi 9.07

Me kërkesë Shqipëria do të informojë DND dhe personelin Kanadez për ligjet lokale dhe rregullat të cilat mund të kenë lidhje me ta gjatë kryerjes së detyrës së tyre.

Paragrafi 9.08

SHQIPËRIA do të ndihmojë në riatdhesimin e personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre ne rastet kur, në opinionin e KANADASË OSE SHQIPËRISË , jeta ose siguria e personave Kanadezë është ne rrezik.

Paragrafi 9. 09

SHQIPËRIA do t'i sigurojë tërë personelit Kanadez dhe familjarëve të tyre viza me shumë hyrje-dalje për udhëtim, por edhe nga Shqipëria dhe do të jetë përgjegjëse të sigurojë certifikatat e sigurisë, lejet dhe dokumentet e tjera të ngjashme për DND për implementimin me sukses të projektit.

Paragrafi 9.10

SHQIPËRIA do t'u sigurojë përfaqësuesve të personelit të CIDA dhe personelit Kanadez të gjitha lehtësirat e nevojshme të vizitojnë çdo vend në Shqipëri për aktivitete zyrtare që lidhen me projektin.

Neni 10

Informacion

Paragrafi 10 .01

KANADAJA dhe SHQIPËRIA do të sigurojnë që ky Memorandum Mirëkuptimi të implementohet me zellin e duhur dhe eficencë, dhe do t'i japin tjetrës informacione që kanë të bëjnë me projektin siç është e arsyeshme të bëhet.

Neni 11

Komunikimet

Paragrafi 11. 01

Çdo komunikim ose dokument i dhënë, i bërë ose i dërguar nga KANADAJA ose SHQIPËRIA në zbatim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi , do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtëme :

For CANADA : The Program Manager RZE
Central and Eastern Europe
Canadian International Development Agency
200Promenade du Portage
Hull , Quebek
KIA OG4
Facsimile : 994–3669
For ALBANIA : Directorate of Civil Aviation
Rr " Durrësit " No 202
Tirana , Albania
Facsimile :3554226232/23969

Paragrafi 11.02

KANADAJA ose SHQIPËRIA, me anë të një njoftimi me shkrim të adresës, mund të ndryshojnë adresën në të cilën dorëzohen të gjithë dokumentet ose komunikimet.

Paragrafi 11.03

Të gjithë dokumentet dhe komunikimet për KANADANË do të jenë në gjuhën angleze ose frënge , dhe të gjitha dokumentet dhe komunikimet për SHQIPËRINË do të jenë në gjuhën angleze

ose frënge.

Neni 12
Konsultimet

Paragrafi 12. 01
KANADAJA dhe SHQIPËRIA do të konsultohen ndërmjet tyre për çdo problem që mund të dalë në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Neni 13
Aplikimi

Paragrafi 13. 01
Ndryshimet që mund të dalin në aplikimin e parapërgatitjes së këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të përcaktohen me negociata midis KANADASË dhe SHQIPËRISË , me ndonjë mënyrë tjetër të rënë dakord reciprokisht.

Paragrafi 14. 01
Ky Memorandum Mirëkuptimi së bashku me anekset "A" "B" dhe "C", ku secila është një pjesë integrale, formojnë Memorandumin e plotë midis KANADASË dhe SHQIPËRISË sipas Projektit.

Paragrafi 14.02
Memorandumi i Mirëkuptimit mund të përmirësohet nëse mund të shihet e nevojshme nga KANADAJA dhe SHQIPËRIA , përmes shkëmbimit të letrave.

Paragrafi 14. 03
Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi dhe do të ketë veprim ditën e nënshkrimit dhe do të mbesë kështu deri më 31 dhjetor 2001.

Për Qeverinë Republikës së Shqipërisë Për Qeverinë Kanadeze

ANEKSI "A"

PROJEKTI PËR NDËRTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË RI TË AVIONËVE CIVILë NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË RINASIT, PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

SFONDI
Shqipëria ka mbajtur peshën kryesore të krizës së refugjatëve kosovarë. Megjithëse vendi më i varfër në Europë ajo mirëpriti mbi 400 000 shqipëtarë të Kosovës , gjë e cila solli një shtrëngim të veçantë të financave të saj publike dhe kufizoji strukturën e saj. Vështirësitë ekonomike të Shqipërisë kanë qenë një kompleks i përçarjes së tregëtisë rajonale të transportit dhe investimeve .
Me përfundimin e konfliktit , një nga vendet e para të indetifikuara për aksionin ndërkombëtar është rehabilitimi i rrugëve lidhëse dhe i vendqëndrimit në Aeroportin e Rinasit.
Aeroporti i Rinasit lokalizohet afërsisht 25 km nga Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë. është i vetmi Aeroport Ndërkombëtar në Shqipëri dhe zhvillimi i tij është cilësi për një zhvillim ekonomik të vendit.

Aeroporti i Rinasit gjatë krizës së Kosovës nuk ishte vetëm aeroporti i parë për ndihmë humanitare, por ishte gjithashtu baza kryesore për forcat e NATO – AFOR. Pista, së bashku me rrugët lidhëse dhe vendqëndrimin u dëmtuan nga numri i madh dhe madhësia e aeroplanëve që përdorën aeroportin. NATO ka rënë dakord që të riparojë dëmtimin që iu atribua përdorimt nga forcat e saj të aeroportit . CIDA do të mbështesë ndërtimin e vendqëndrimit të ri të avionëve civilë sipas

standardeve të plota ndërkombëtare. Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale shprehu një interes në pjesëmarrjen në këtë inisiativë dhe mori përsipër misionin e pajtimit në gusht 2000. Departamenti i Mbrojtjes Nacionale (DND) ka rënë dakord të skicoje dhe të mbikqyrë ekzekutimin e projektit, i cili do të realizohet përmes kontraktorëve konkurues lokalë të zgjedhur.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti i propozuar përfshin ndërtimin e 80m x 150m vendqëndrimi shtesë . Ky zhvillim përputhet me planin e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin afatgjatë të aeroportit.

Kalendari i propozuar i zbatimit :

- Skicimi dhe parapregatitjet specifike 3 muaj
- Skicimi pasqyra specifike dhe aprovimet 1 muaj
- Tenderi i Projektit 2 muaj
- Ndërtimi 3 muaj
- Raporti final 3 muaj

Një grup prej pesë personash është i nevojshëm për 6 muaj (për fazën e tenderimit dhe ndërtimit).

Prokurimi : Për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik në Shqipëri, të gjithë materjalet e ndërtimit për projektin do të nevojiten të importohen. Gjithashtu, kjo nuk mban parasysh probleme teknike përveç rrezikun që kalendari i ngjeshur i zbatimit të projektit është real, prandaj mund të kërkojë një afat tjetër ekstra.

Mjedisi : Në përputhje me Aktin Kanadez të vlerësimit të ambientit, CIDA ka drejtuar një ekranizim të ambientit të territorit të Aeroportit. Nuk pritet të ndodhë ndonjë kundërshtim për efekte të mjedisit nga zbatimi i kësaj inisiative. Puna do të rezultojë në përfitimin direkt të ambjentit në afrimin e menjëhershëm të aeroportit duke përfshirë zgjerimin e tokës fermere dhe bonifikimin e rrëkeve të degraduara nga gërryerjet e dheut dhe nga ndotjet e shumta, argjila dhe dhera. Në përputhje me rekomandimet e vlerësimet , CIDA do të shikojë mundësitë e afrimit të një specialisti të agrikulturës për t'u këshilluar me planin e disponueshëm për materialet ndotëse.

Menaxhimi :Kërkesa për propozimin e një kontraktori lokal do të bëhet në Tiranë. DND do të përgatisë Termat e Referencës dhe do të jetë palë në grupin e vlerësimit me përfaqësuesin e CIDA dhe përfaqësuesin lokal . Seleksionimi i kontraktorit duhet të aprovohet nnga Ministri i CIDA . Një kontratë do të nënshkruhet ndërmjet kontraktorit lokal dhe Post –it. DND do të verifikojë të gjithë faturat sipas zhvillimit të ndërtimit dhe Post do të paguajë për shpenzimet. SHQIPËRIA do të jetë përgjegjëse për çështjet e përshkruara neë anekset "B" dhe "D".

ANEKSI "B"

PLANI IMENAXHIMIT

Situata . Projekti i Aeroportit të Rinasit është iniciativë bilaterale CIDA –DND për të ndihmuar dhe rizhvilluar fushën e Aviacionit të Rinasit. Aeroporti i Rinasit gjatë krizës kosovare nuk ishte vetëm Aeroporti i parë për ndihmën humanitare, por ishte gjithashtu baza kryesore për forcat e NATO –AFOR –it . Numri i madh i avionëve dhe përmasat e mëdha të tyre dëmtuan pistën , rrugët e taksingut dhe vendqëndrimin. CIDA do të mbështesë ndërtimin e vendqëndrimit të avionëve tërësisht sipas standarteve ndërkombëtare. Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale shprehu një interes për pjesëmarrjen në këtë inisjativë dhe mori përsipër misionin e pajtimit në gusht 2000. DND ka rënë dakord të skicojë dhe mbikqyrë ekzekutimin e projektit i cili do të realizohet përmes kontraktorëve konkurues lokal të zgjedhur.

Misioni. Të ndërtohet 80 x 150 m shtesë vendqëndrim i ri avioni tek terminali ekzistues në Aeroportin e Rinasit.

Ekzekutimi. Paraqitje e përgjithshme : Ky projekt do të tenderohet në Shqipëri në një proces të hapur tenderimi. Financimi i projektit do të sigurohet nga CIDA dhe Departamenti Kanadez i Mbrojtjes Nacionale do të sigurojë shërbime të skicimit dhe projektin e përgjithshëm të menaxhimit Financimi Total Kanadez nuk do ti kalojë $2,1 Cdn.

Detyrat. Projekti do të realizohet në katër faza.

Faza I . Parapërcaktim : Kjo fazë tashmë ka filluar dhe do të përfundojë në mars 2001. Çështjet për t'u kryer gjatë kësaj faze janë si më poshtë :

Agjenci : Grupi i menaxhimit të projektit i DND (P. M. team)

Detyrat : I gjithë projekti i skicuar, duke përfshirë vizatimet dhe specifikimet e kontratës.

Përgatitje për dokumentet e tenderit .

Përgatitja dhe përkthimi i shpalljes së tenderit .

Përgatitja e matricës së vlerësimit të tenderit .

Finalizimi i marrveshjes administrative midis DND dhe CIDA.

Plani komplet i projektit të menaxhimit si aneks i MOU ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë.

Bërja e rregullimeve administrative për sistemimin dhe transportin e grupit të punës në Shqipëri.

Agjenci CIDA

Detyrat : Ndihmë grupit PM për përgatitjen e shpalljes së tenderit .

Ndihmë grupit PM për përgatitjen e matricës së vlerësimit të tenderit .

Finalizimi i MOU midis Shqipërisë dhe Kanadasë

Finalizimi i marrëveshjes administrative midis DND dhe CIDA .

Kompletimi i impaktit të vlerësimit ambiental .

Agjenci : Qeveria e Shqipërisë (GoA)

Detyrat :Finalizimi i MOU midis Shqipërisë dhe Kanadasë .

Faza II. Paraqitja : Kjo fazë do të fillojë NLT në 4 mars 2001 dhe do të përfundojë me aprovimin e ministrit të CIDA sipas Kontratës . Detyrat që do të kryhen gjarë kësaj faze janë si më poshtë :

Agjenci :Grupi i punës i projektit të Menaxhimit i DND .

Detyrat :Paraqitja fillestare e një personeli prej 3 vetash IDND në Shqipëri .

Pasqyra e planit të projektit të zbatimit me Drejtorin e Aeroportit .

Pasqyra e hapjes së tenderit me këshillimet ligjore lokale .

Shpallja e hapjes së tenderit .

Kontratë për përkthimin e propozimeve /ofertave .

Organizimi i mbledhjes së tenderit dhe vendi .

Marrja dhe vlerësimi i propozimeve /ofertave .

Verifikimi i statusit juridik dhe financiar i kontraktorit të zgjedhur .

Negociata e ndërtimit dhe kalendari i pagesës me kontraktorin e zgjedhur .

Verifikimi i projektbuxhetit dhe indentifikimi i ndonjë kostoje shtesë të pritshme .

Agjenci CIDA :

Detyrat: Pasqyra e hapjes së tenderit me këshillimet ligjore lokale .

Sigurimi i vlefshmërisë së fondeve për shpalljen .

Paraqitja e zyrtarit kontraktor të CIDA në Shqipëri .

Letra e marrë nga Qeveria e Shqipërisë për përjashtimin nga taksat e projektit.

Marrja dhe vlerësimi i propozimeve /ofertave .

Verifikimi i statusit juridik dhe financiar të kontraktorit të zgjedhur.

Negociata , ndërtimi dhe kalendari i pagesave me kontraktorin e zgjedhur.

Verifikimi i projektbuxhetit dhe identifikimi i ndonjë kosto shtesë të pritshëm.

Riparaqitjen e zyrtarit kontraktor të CIDA në Kanada.

Marrja e aprovimit të Ministrit të CIDA sipas kontratës.

Agjenci :Qeveria Shqiptare .

Drejtori i Aeroportit të pasqyrojë planin e Projektit me grupin PM.

Faza III : Implementimi . Kjo fazë do të fillojë me aprovimin e Ministrit të CIDA sipas kontratës dhe do të përfundojë me dorëzimin e projektit autoriteve shqiptare . Detyrat që do të kryhen

gjatë kësaj faze janë si më poshtë:

Agjenci : Grupi i Menaxhimit i projektit të DND.
Detyrat : Paraqitja e pjesës së mbetur të grupit të DND në Shqipëri.
Sigurimi i koordinimit me Drejtorin e Aeroportit.
Verifikimi që kontraktori merr të gjitha lejet e ndërtimit.
Mbikqyrja e kontratës.
Ndërtimi i realizuar është ndërtuar në përputhje me projektin dhe specifikimet.
Mbikqyrja për mbrojtjen e mjedisit.
Kontrata për sigurimin cilësor të testur sipas kërkesës.
Verifikimi i të gjitha faturave dhe pagesave të rekomanduara sipas kalendarit të ndërtimit
Përgatitja e treguesve dhe raporteve financiare .
Përcaktimi komplet i ndërtimit .
Përgatitja e listës së mangësive .
Përgatitja e ndërtesës dhe dhomës së projektimit (disenjimit).
Dorëzimi i projektit në Autoritetet Shqiptare.

Agjenci : CIDA.
Detyrat : Pagesa e të gjitha faturave të rekomanduara për t'u paguar.
Kontrata me specialistin e agrikulturës për mbrojten e mjedisit nëse kërkohet.
Dorëzimi i projektit Autoriteteve Shqiptare.

Agjenci : Qeveria Shqiptare
Detyrat:Ndihmesa për marrjen e ndërtesave dhe lejeve të ndërtimit të kërkuara.
Drejtori i Aeroportit të koordinojë me grupin PM.

Faza IV . Riparaqitja. Kjo fazë do të fillojë me dorëzimin e projektit Autoriteve Shqiptare dhe do të përfundojë me pagesën finale të DND nga CIDA . Detyrat për tu kryer gjatë kësaj faze janë si më poshtë :

Agjensi : Grupi i Menaxhimit të projektit të DND.
Detyra : Vendosja e të gjitha llogarive administrative në Shqipëri.
Riparaqitja e tërë grupit të projektit të Kanadasë . Paraqitja dhe bashkëngjitja në Raportin final për CIDA.
Përgatitja e faturës finale për shërbimet e DND për CIDA.
Agjenci : CIDA .
Detyrat : Pagesa e faturës finale për shërbimet e DND.
Suporti i shërbimit.
Sistemimi : Anëtarët e grupit të PM do të sistemohen në banesa me qira në Tiranë.
Transporti : Grupi i PM do të regullojë transportin dhe lëvizjet e anetarëve në Shqipëri.
Komanda dhe Sinjalet.
Menaxheri i projektit : Menaxheri i projektit për këtë projekt është Majori Andrea Penney, i forcave të Armatosura të Kanadasë.

Raportet dhe kthimet.

Raporti final :Menaxheri i projektit do të bashkëngjisë një raport final tregues (NLT) disa ditë pas dorëzimit të projektit.

Raportet e përkohshme : Menaxheri i projektit do t'i bashkëngjisë raporteve të zhvillimit të përkohshëm për CIDA IAW kalendarin e mëposhtëm:

Në zgjedhjen e kontraktorit;

kur rekomandohen pagesat.

në dorëzimin e projektit.

Kohëzgjatja : Koha për tërë aktivitetin e kalendareve është bashkëngjitur në hartën Gar.

Afatet e rëndësishme janë si më poshtë:

23 shkurt 01 Kompletimi i skicimit të projektit

09 Prill 01 Aprovimi i Ministrit të CIDA sipas kontratës

31 Korrik 01 Dorëzimi i projektit të kompletuar.

Aneksi "C"

PËRGJEGJËSITË E KANADASË

KANADAJA do të financojë shpenzimet e mëposhtme bazuar në vlerësimet e autorizuara .

1. Shpenzimet në lidhje me Personelin Kanadez:

a) Rrogat e tyre, shpërblimet, lejet dhe përfitime të tjera .

b) Shpenzimet e udhëtimit dhe të familjarëve të varur nga to , që nga vendi i tyre i qëndrimit në portën e hyrje – dalje, në Shqipëri.

c) Koston e transportit , nga vendi i tyre në portën e hyrje –dalje në Shqipëri , për pajisje personale dhe materialet profesionale dhe teknike të kërkuara nga Personeli Kanadez për kryerjen e detyrës së tyre.

Kontratat për blerjen e mallrave apo për autorizimin e shërbimeve të financuara nga KANADAJA dhe të kërkuara për kryerjen e projektit, do të nënshkruhen nga KANADAJA ose nga njëra prej agjencive të saj.

KANADAJA do të pajisë SHQIPËRINË me kohë me emrat e personelit Kanadez sipas të drejtave dhe privilegjeve të vendosura në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Aneksi "D"

PËRGJEGJËSITË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SHQIPËRIA do të sigurojë ose paguajë për :

1. Indentifikimin dhe shpërblimin në ekuivalencë të përshtatshme që të sigurojë zbatimin e projektit.

2. Çdo ndihmë zyrtare që mund të kërkohet për qëllim të lehtësimit të udhëtimit të CF dhe DND dhe personelit kanadez në kryerjen e detyres së tyre në Shqipëri.

3. Çdo ndihmë zyrtare që mund të kërkohet për qëllim të lehtësimit të pagesave përmes doganave për pajisjet, produktet, materjalet, pajisjet e zyrave dhe mallrat e tjera që nevojiten për kryerjen e projektit dhe pajisjet personale shtëpiake të personelit Kanadez.

4. Të gjitha lejet, licencat dhe dokumentet e tjera, duke përfshirë koston e tyre për CF dhe DND, për firmat dhe personelin Kanadez për të kryer funksionet e tyre në SHQIPËRI.

5. Të gjitha vizat e nevojshme dhe të gjitha lejet e import-eksportit, sipas rastit, për personelin kanadez, për pajisjet, materialet, pajisjet apo mallrat e nevojshme për kryerjen e projektit, pajisjet profesionale dhe teknike dhe pajisjet personale të personelit Kanadez .

6. Ndihmesë për të siguruar transport të menjëhershëm në vend të të gjitha mjeteve, produkteve materialeve, pajisjeve dhe të mirat e tjera të importuara të nevojshme për kryerjen e projektit, nga porta e hyrjes në Shqipëri në teritorin e projektit, duke përfshirë ku është e nevojshme, marrjen e prioritetit nga Shqipëria dhe agjentëve të transportit.

7. Lejen nga Ministria përkatëse në përputhje me ligjin përkatës dhe rregullat , për të përdorur të gjitha mjetet e komunikimit si radio transmetueset e frekuencave të larta dhe marrësit e aprovuar për përdorim në Shqipëri , telefon dhe rrjetin telegrafik , sipas nevojave të projektit .

8. Raportet, të dhënat , hartat , statistikat dhe informacione të tjera të lidhura me projektin dhe

të përshtatshme të ndihmojnë CF dhe DND dhe personelin Kanadez në kryerjen e detyrave të tyre, të siguruar që nuk janë klasifikuar dhe s'kanë asnjë lidhje me sigurinë nacionale .

9. Çdo asistencë siç përshkruhet në planin e menaxhimit.